VIETNAM

PROGRAMI I UDHËTIMIT | 06–13 PRILL 2027

DITA 1 – 06 PRILL 2027: HANOI – MBËRRITJA – KOHË E LIRË (-)

Fluturimi ne vajtje: TK 164 | 06 PRILL | Stamboll – Hanoi | 02:10–15:30

Pas mbërritjes në Aeroportin Ndërkombëtar Noi Bai, do t'ju presin shoferi ynë privat dhe guida anglisht - folëse, të cilët do t'ju shoqërojnë drejt hotelit. Pjesa tjetër e ditës do të jetë e lirë për ta kaluar sipas dëshirës suaj.

Fjetja: Në Hanoi.






DITA 2 – 07 PRILL: HANOI – EKSKURSION NJËDITOR NË QYTET (M)

Pas mëngjesit, takimi me guidën anglisht – folëse dhe shoferin për të nisur **një vizitë njëditore në Hanoi**. Do të vizitoni kompleksin historik **Ho Chi Minh** (*Sheshin Ba Dinh, Mauzoleumin* e Ho Chi Minh dhe shtëpinë e tij mbi shtylla), faltoren ikonike me një shtyllë (**One Pillar Pagoda**), si dhe **Tempullin e Letërsisë** – *universiteti i parë kombëtar i Vietnamit.*

Pasdite, do të shijoni një **shëtitje tradicionale me ciklo** nëpër lagjen e vjetër plot gjallëri, si dhe një shëtitje në këmbë përreth liqenit piktoresk **Hoan Kiem** dhe **Tempullit Ngoc Son.**

Fjetja: Në Hanoi.



DITA 3 – 08 PRILL: HANOI – GJIRI HA LONG – UDHËTIM ME FJETJE NË BORD (M/D/D)

Pas **mëngjesi**t, takimi me guiden dhe shoferin për një transfertë private drejt **Gjirit Ha Long**, një zonë e përfshirë në *Listën e Trashëgimisë Botërore të UNESCO*-s. Mbërritja në port parashikohet rreth mesditës, ku do të kryhet imbarkimi në anije. **Dreka do të shërbehet** ndërsa anija lundron drejt gjirit.

Gjatë pasdites do të zhvillohen ekskursione të planifikuara ose mund të relaksoheni në bord. Anija do të ankorohet mes formacioneve karstike për darkën dhe qëndrimin gjatë natës.

Shënime:

- Itinerari mund të ndryshojë në varësi të kushteve atmosferike ose rregulloreve lokale.
- Vaktet përfshijnë alternativa lokale dhe ndërkombëtare; pijet paguhen veçmas nga udhëtarët.
- Guida jonë private do t'ju shoqërojë vetëm gjatë transfertës tokësore. Gjatë lundrimit, do të ndani guidën që flet anglisht me udhëtarë të tjerë.

Fjetja: Në bord, në Gjirin Ha Long.





DITA 4 – 09 PRILL: GJIRI HA LONG – HANOI – DA NANG (M/BRUNCH)

Fluturimi: VJ 523 | 09 PRILL | Hanoi – Da Nang | 20:10–21:30

Shijoni lindjen e diellit mbi gji, e ndjekur nga *një mëngjes i lehtë (ose brunch),* ndërsa anija lundron drejt portit. Zbritja nga anija parashikohet rreth orës **11:30.** Më pas, do të takoheni me guidën dhe shoferin tonë privat për *transfertën e kthimit në Hanoi,* në kohë për fluturimin drejt **Da Nang.**

Pas mbërritjes, guida dhe shoferi ynë do t'ju shoqërojnë drejt hotelit. Pjesën e mbetur të ditës mund ta shijoni sipas dëshirës suaj.

Fjetja: Në Da Nang.





DITA 5 – 10 PRILL: DA NANG – BA NA HILLS – URA E ARTË (M)

Mëngjesi në hotel. Më pas, guida dhe shoferi ynë do t'ju shoqërojnë drejt kompleksit **Sun World Ba Na Hills**. Do të ngjiteni në majë me **një nga teleferikët më të gjatë në botë**, duke shijuar pamje panoramike të pyjeve dhe vijës bregdetare.

Shetitje mbi **Urën ikonike të Artë (Golden Bridge),** e cila mbahet nga duar gjigante, dhe do të eksploroni kopshtet me lule **Le Jardin D'Amour** dhe **Fshatin Francez** (French Village).

Pasditja do të jetë e lirë për të shijuar kompleksin sipas dëshirës, nga parku i brendshëm i argëtimit Fantasy Park deri te faltoret e qeta dhe vilat e stilit evropian.

Shënim:

- Paketa jonë përfshin vetëm biletat e teleferikut.
- Përvojat e tjera opsionale, si vizita në bodrumet e verës (Wine Cellars), Muzeu i Dyllit, monedhat për lojërat në Fantasy Park etj., paguhen nga vetë udhëtarët.

Fjetja: Në Da Nang.




RESTAURANT



DITA 6 – 11 PRILL: DA NANG – HOI AN – FSHATI CAM THANH – QYTETI I VJETËR HOI AN – HO CHI MINH (M)

Fluturimi: VJ 643 | 11 PRILL | Da Nang – Ho Chi Minh | 20:35–22:00

Pas mëngjesit, takoheni me guidën dhe shoferin tonë për transfertën drejt fshatit **Cam Thanh**. Do keni mundesine te eksploroni pyllin e gjelbër me palma kokosi ujore dhe përjetoni një shëtitje me varkën tradicionale vietnameze në formë shporte, duke lundruar nëpër kanalet e qeta.

Më pas, vazhdoni me një tur në këmbë të shoqëruar nga guida në qytetin e vjetër **Hoi An**, ku do të zbuloni shtëpitë karakteristike të tregtarëve, **Urën Japoneze të Mbuluar 400-vjeçare**, **Sallën e Asambleve Kineze, shtëpitë tradicionale vietnameze, muzetë lokalë dhe tregun plot gjallëri** (blerjet kryhen me shpenzimet tuaja).

Më pas, do të transferoheni në Aeroportin e Da Nang për fluturimin drejt qytetit **Ho Chi Minh**. Pas mbërritjes, do t'ju presin guida dhe shoferi ynë për transfertën private drejt hotelit. Pjesën e mbetur të ditës mund ta shijoni sipas dëshirës.

Fjetja: Në Ho Chi Minh City.





DITA 7 – 12 PRILL: HO CHI MINH – DELTA E MEKONGUT (M/D)


Pas mëngjesit, takoheni me guidën tonë dhe niseni nga **Ho Chi Minh City drejt Ben Tre.** Shijoni një lundrim me varkë përgjatë lumit Ham Luong. Vizitoni ishullin Long Thanh për të provuar *fruta tropikale dhe çaj me mjaltë në një shtëpi lokale.*

Vazhdoni drejt **Mo Cay** për të eksploruar punishte ku prodhohen karamele kokosi dhe fshesa. Përjetoni një udhëtim tradicional me automjetin lokal xe lam dhe më pas një shëtitje të qetë me varkë sampan përgjatë kanaleve.

Shijoni një drekë të shijshme lokale në një shtëpi buzë lumit, e ndjekur nga një shëtitje e qetë për të zbuluar jetën e përditshme të banorëve vendas, përpara kthimit në **Ho Chi Minh City.**

Dreka në një restorant lokal (përfshihet ushqimi, pijet nuk përfshihen).

Fjetja: Në Ho Chi Minh City.



DITA 8 – 13 PRILL: HO CHI MINH – TUR NË QYTET DHE TUR GJYSMËDITOR ME VESPA, ME DEGUSTIM USHQIMESH RRUGE (PRIVAT) (M)

Fluturimi I kthimit: TK 163 | 13 PRILL | Ho Chi Minh – Stamboll | 22:15–04:45

Pas mëngjesit, takohuni me guidën dhe shoferin tonë për një vizitë paradite në qytetin **Ho Chi Minh**. Do të vizitoni disa nga monumentet kryesore të qytetit, si **Pallati historik i Ribashkimit (Reunification Palace), Katedralja mbresëlënëse Notre-Dame dhe Posta Qendrore.**

Më pas, do të shijoni një tur plot gjallëri për të provuar ushqimet tradicionale të rrugës në **Saigon**, duke udhëtuar si pasagjerë në pjesën e pasme të një **skuteri klasik Vespa**, të shoqëruar nga një mikpritës vendas (12:30–16:30). Do të **zbuloni specialitete të Vietnamit Jugor, si Bánh Xèo, Bánh Mì, ëmbëlsira tradicionale dhe fruta deti të freskëta.**

Gjithashtu, do të eksploroni tregjet shumëngjyrëshe të luleve dhe ushqimeve lokale, duke përjetuar shijet autentike dhe atmosferën e gjallë të jetës së përditshme në Saigon.

Pas përfundimit të turit, do të transferoheni në **Aeroportin Ndërkombëtar Tan Son Nhat** për fluturimin e kthimit.











Çmimi i udhëtimit:

- **2,890 € / person** në dhomë dyshe

Suplementi për dhomë teke:

- **+390 €**

Çmimi përfshin:

- Biletat e avionit vajtje-ardhje, me 20 kg bagazh të regjistruar
- Fluturimet e brendshme në Vietnam
- Transfertat aeroport – hotel – aeroport
- Transfertat e brendshme sipas programit
- Akomodimin për 7 netë, me mëngjes
- Vaktet e përfshira në program
- Turet dhe ekskursionet e përfshira në program
- Vizën
- Siguracionin shëndetësor të udhëtimit
- Shoqërues shqiptar gjatë udhëtimit

Çmimi nuk përfshin:

- Vaktet që nuk janë të specifikuara në program
- Hyrjet në monumentet që nuk janë të përfshira në program
- Turet dhe ekskursionet shtesë
- Bakshishet

INFORMACION I RËNDËSISHËM

- Rekomandojmë që të gjithë udhëtarët të pajisen me siguracion shëndetësor për çdo udhëtim.
- Pasaporta duhet të jetë e padëmtuar dhe të ketë një afat vlefshmërie prej të paktën 6 muajsh.

KUSHTET E PAGESËS

Pagesa për rezervimin kryhet në dy këste:

- **50%** e shumës totale në momentin e rezervimit.
- **50%** e mbetur, jo më vonë se 21 ditë përpara nisjes.

Për çdo ndryshim të specifikave të rezervimit, mund të na kontaktoni në një nga numrat e telefonit ose në adresën tonë të e-mailit.

POLITIKA E ANULIMIT

Në rast anulimi nga ana e klientit, aplikohen penalitetet e mëposhtme:

- **50%** e shumës totale në rast anulimi deri në 30 ditë përpara nisjes.
- **80%** e shumës totale në rast anulimi nga 30 deri në 14 ditë përpara nisjes.
- **100%** e shumës totale në rast anulimi 14 ditë ose më pak përpara nisjes.